

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), ndërsa duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Erxhan Sullkoski, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut XXX, përmes Gjorgji Donovski, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 16.07.2025, solli këtë:

AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Erxhan Sullkoski, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut XXX ka fituar kontroll mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup me seli në rr. Dame Gruev nr. 16 Shkup, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin e dukshëm, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Obligohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftim për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për vendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për iniciimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Ligji), më datë 16.05.2025, e plotësuar më 05.06.2025, 23.06.2025 dhe më 03.07.2025, deri te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Erxhan Sullkoski, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut XXX me të cilin Erxhan Sullkoski ka fituar kontroll mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup me seli në rr. Dame Gruev nr. 16 Shkup, përmes shitblerjes së pjesëve. Përqendrimi është realizuar në vitin 2022.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit me ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimit dhe shtojcave të tyre vërtetoi këtë:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Personi fizik Erxhan Sullkoski është pronar i vetëm i Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime PACIFIK PETROLEUM import-eksport SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Dane Krapçev nr. 12 Shkup. PACIFIK PETROLEUM import-eksport SHPKNJP Shkup është me veprimtari mbizotëruese transportin e mallrave dhe e njëjta posedon Licencë për kryerjen e

transportit publik të mallrave dhe Miratim për kryerjen e transportit të materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor, me ç ‘rast e njëjta kryen transport të materieve të rrezikshme: Eurosuper BS – 95, Eurosuper BS -98, eurodizel BS (D-E V), Ekstra e lehtë 1 (el-1) dhe TNG (gaz i lëngshëm i naftës).

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime RKM SHPK Shkup kryen tregti me shumicë me lëndë djegëse të ngurta, të lëngshme dhe të gazta dhe atë tregti me shumicë me Mazut (M-1).

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ